



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 145/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të vendosjes së panove në trafo elektrike, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

VENDIM

KONSTATOHET tërheqja e ankesës e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ZL. A.nr. 145/2017 të datës 09.10.2017.

Arsyetim

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, për shkak të vendosjes së panove të Kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal, nga radhët e subjektit politik LDK, në Ortakoll përballë shkollës “Abdyl Frashëri”, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22 tetor 2017.

Me datë 10.10.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesë me numër: Anr.145/2017 të datës 09.10.2017.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, PZAP -i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.145/2017 më datën 10.10.2017



Kryesues i Panelit
Zyhdi Haziri